



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



Analizë e shpenzimeve operative për vitin 2018

Departamenti i Tarifave
2019 Prishtinë

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe eficiente të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

Misioni

“Regullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit Publik”

PËRMBAJTA

1	PARATHËNIE	5
2	QËLLIMI I ANALIZËS	6
3	SFIDIMI I SHPENZIMEVE OPERATIVE	7
4	SHPENZIMET OPERATIVE PËR SHËRBIMET E UJIT	8
4.1	Shpenzimet operative në resurse dhe trajtim të ujit	8
4.2	Shpenzimet operative në distribuim të ujit.....	10
4.1	Shpenzimet operative në aktivitetet biznesore të ujit	12
5	SHPENZIMET OPERATIVE PËR UJËRA TË NDOTURA	14
5. 1	Shpenzimet operative për grumbullimin e ujërave të ndotura.....	15
5. 2	Shpenzimet operative për aktivitetet biznesore të ujërave të ndotura.....	17
6	KONKLUZIONET	19

Akronimet dhe shkurtesat

ARRU	Autoriteti Rregulator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPRR	Biznes Plane Rregullatore
BRRA	Baza Rregullatore e Aseteve
DRP	Departamenti për raportim të performancës në ARRU
DT	Departamenti i Tarifave në ARRU
FE	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Bifurkacioni” sh. a –Ferizaj
FPU	Fabrika e Përpunimit të Ujit
GJA	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Radoniqi” sh. a – Gjakovë
GJI	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidromorava” sh. a – Gjilan
GSJP	Grupi për Studime Juridike dhe Politike
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
MIT	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Mitrovica” sh. a – Mitrovicë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NjPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
PE	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidrodrini” sh. a – Pejë
PR	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Prishtina” sh. a – Prishtinë
PZ	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidroregioni-Jugor” sh. a – Prizren
U.N	Ujëra të ndotura

1 PARATHËNIE

Duke marrë parasysh praktikat e mira, të përvetësuara nga ARRU dhe bazuar në nevojat për analiza lidhur me të dhënat e realizuara nga KRU, kemi paraparë të nevojshme një analizë lidhur me shpenzimet operative të realizuara për vitin 2018. Zakonisht ARRU përpilon raport vjetor të performancës dhe raport vjetor të arritjes së caqeve të aprovuara nga rregullatori. Për dallim nga dy raportet e cekura analiza në vijim do të fokusohet në rrafshin horizontal për të krahasuar të shtatë KRU-të bazuar në të dhënat e realizuara për vitin 2018.

Raporti është punuar mbi bazën e të dhënavët të realizuara nga KRU dhe të audituara nga ARRU për vitin 2018

2 QËLLIMI I ANALİZËS

Procesi tarifor që udhëheq ARRU paraqet një tërësi komplekse të informatave të ndryshme të KRU-ve, përmes të cilave jo vetëm që caktohen tarifat për shërbimet e ujit dhe të ujërave të ndotura, por aty determinohen edhe një mori të dhënash operative, financiare dhe të investimeve kapitale që i arsyetojnë ato tarifa. Për dallim nga Raportet mbi përbushjen e caqeve ku raportohen të dhënata e realizuara dhe ato të aprovuara nga ARRU, qëllimi i kësaj analize është të fokusohet në analizën e shpenzimeve operative të realizuara gjatë vitit 2018.

Edhe pse KRU veprojnë në kushte relativisht të njëjta të afarizmit gjatë përpilimit të raporteve ne kemi vërejtur se shpenzimet operative sipas kosto qendrave dallojnë shumë nga një KRU tek tjetra. Me këtë analizë do të pasqyrojmë këto dallime dhe në bazë të analizave do të jepen rekomandime në drejtim të vendosjes së standardeve respektivisht kornizave për shpenzimet operative jo vetëm për shërbime të ujit dhe ujërave të ndotura por edhe për nën kategoritë e shpenzimeve.

Të dhënata e shpenzimeve operative të paraqitura në këtë raport janë kategorizuar konform udhëzimeve të kontabilitetit rregullator, fillimisht duke i ndarë shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura.

Sipas UKRR, shpenzimet operative i ndajmë në tre kategori:

- shpenzimet operative në resurse dhe trajtim
- shpenzimet operative në distribuim-shpërndarje, dhe
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Ndërkaq, shpenzimet operative për ujëra të ndotura, janë të ndara në 4 kategori, dhe atë:

- shpenzimet operative në grumbullimin e ujërave të ndotura
- shpenzimet operative në trajtimin e ujërave të ndotura
- shpenzimet operative në trajtimin e llumit
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Shpenzimet operative për shërbimet e ujit do të analizohen për nën kategoritë e shpenzime të Prodhimit të ujit, Distribuimit të ujit dhe Aktivitetave biznesore (shpenzimet e përbashkëta).

Kurse për shpenzimet operative për shërbimet e ujërave të ndotura do të analizohen nën kategoritë e shpenzimeve të Grumbullimit të ujërave të ndotura dhe aktivitetet biznesore duke përjashtuar trajtimin e ujërave të ndotura si dhe trajtimin e llumit, pasi shumica e KRU-ve nuk kanë trajtim të ujërave të ndotura.

3 SFIDIMI I SHPENZIMEVE OPERATIVE

Me qëllim që analiza të mos mbetet vetëm në përshkrimin e gjendjes së shpenzimeve operative në sektorin e ujit, duke marrë parasysh të dhënrat, kemi menduar të sfidojmë ato KRU të cilat shpenzimet për kosto qendra të ndryshme i kanë mbi mesataren e sektorit. Sfidimi, si metodë për të ofruar KRU-të me efikasitet më të dobët tek mesatarja e sektorit konsiston në këtë metodologji.

Në tabelat e prezantuara më poshtë do të paraqitet efikasiteti i shtatë KRU për secilën kosto qendër për shërbimet e ujit dhe të ujërave të ndotura. Në vazhdim do të paraqesim edhe mesataren e thjeshtë të efikasitetit dhe për KRU të cilat kanë efikasitet më të mirë se mesatarja nuk do të sfidohen, kurse KRU të cilat gjinden mbi mesatare të kostove për njësi (me efikasitet më të dobët), do të sfidohen me qëllim që edhe ato të ofrohen te mesatarja, respektivisht të eliminohen dallimet nga një KRU te tjetra. Me qëllim që mos të sforcohen KRU-të të cilat sfidohen ne nuk kemi kërkuar nga këto kompani të performojnë si mesatarja por kemi menduar që kompanitë të sfidohen për një të tretën e kostove përtej kostos mesatare. Me këtë qasje pas tri sfidimeve KRU-të do të performojnë njësoj si edhe mesatarja e sektorit. Në grafikonet e paraqitura për secilën kosto qendër KRU-të të cilat i kanë shpenzimet për njësi mbi mesatare janë sfiduar për një të tretën e rrugës për të arritur te mesatarja (nga pikat me ngjyrë të kaltër në pikën me ngjyrë të kuqe).

Gjithsesi duhet pas parasysh se shpejtësia me të cilën KRU-të sfidohen për të arrit tek mesatarja e sektorit mund të ndryshoj varësisht nga vendimet e ARRU.

4 SHPENZIMET OPERATIVE PËR SHËRBIMET E UJIT

4.1 Shpenzimet operative në resurse dhe trajtim të ujit

Gjatë procesit të përcaktimit të tarifave, ARRU aprovon një mori të dhënash, të cilat e përcaktojnë afarizmin e KRU-së përgjatë tre viteve të procesit tarifor. Një ndër komponentët e BPRR është edhe aprovimi i shpenzimeve operative. Pasi shpenzimet operative ndikojnë drejtpërdrejt në lartësinë e tarifave, me anë të analizës ARRU do të arsyetoj sfidimet e BPRR të KRU-ve gjatë aplikimit për procesin tarifor 2021-2023 sa i përket komponentës së shpenzimeve operative. Përmes tabelës në vijim do të paraqesim kostot në euro për të prodhuar një mijë metra kub ujë (€/1000m³), për shtatë KRU dhe për sektorin.


Tabela Nr. 1. Shpenzimet operative të realizuara në resurse dhe trajtim të ujit të pjesës përvitit 2018 duke përashtuar shpenzimet e energjisë dhe të shpenzimet ngarkesës së shërbimeve e(uji me shumicë i pa përpunuuar)

KRU	Shpenzimet në resurse dhe trajtim	Prodhimi ne m ³	€/1000 m ³	Krahasimi me mesataren e sektorit	Shpenzimet e sfiduara per 1000 m ³ uje
PR	999,482	51,999,576	19.22	-8.60	19.22
PZ	729,590	17,038,292	42.82	15.00	37.82
PE	93,836	25,366,310	3.70	-24.12	3.70
MI	524,898	28,347,492	18.52	-9.31	18.52
GJA	700,926	14,992,458	46.75	18.93	40.44
FE	218,495	7,793,097	28.04	0.21	27.97
GJI	302,360	8,464,519	35.72	-8.60	33.09
SEKTORI	3,569,587	154,001,744	27.82		

Nga tabela vërejmë se edhe pse kemi mënjanuar shpenzimet operative për ngarkesë përvitin me shumicë (për shkak se jo të gjitha KRU-të blejnë ujin e pa përpunuuar), si dhe shpenzimet e energjisë (disa KRU kanë më shumë nevojë për energji se të tjerat), me çka jemi përpjekur të barazojmë kushtet e operimit për KRU, prapë se prapë dallimi është evident.

E pa krahasuar duket KRU Hidrodrini e cila dallon shumë nga KRU-të tjera për sa i përket kostos për 1000 m³ ujë të prodhuar. Nëse për shkak të dallimit kaq të madh të KRU Hidrodrini krahasuar me KRU tjera eliminojmë KRU Hidrodrini, atëherë kemi këto dallime të paraqitura në kolonën e fundit.

Derisa kosto mesatare e sektorit është 27.82 €/1000m³, dy nga KRU-të (Mitrovica dhe Prishtina), kanë kosto më pak se 20€/1000m³, KRU Bifurkacioni me 28.00 €/1000m³ dhe KRU Hidromorava me kosto prej 35.70 €/1000m³ bëjnë pjesë në grupin me kosto mesatare dhe dy KRU-të e mbetur (Hidroregjioni jugor dhe Gjakova), kanë kosto mbi 40.00 €/1000m³. ARRU do të jetë e kujdeshme gjatë aprovimit të shpenzimeve operative për trajtimin e ujit të pijes gjatë procesit tarifor 2021-2023, duke marrë parasysh të dhënat nga tabela nr. 1.



Nga trafikoni mund të vërejmë se katër KRU-të (PZ,GJA,FE,GJI), janë sfiduar për një të tretën e dallimit nga mesatarja. Kosto për njësi për PZ është 42.82 €/1000m³, kurse mesatarja është 27.82 €/1000m³, prej nga shihet se dallimi është 15 €/1000m³, por ne nuk kemi sfiduar KRU PZ me 15 €/1000m³ por vetëm me një të tretën d.m.th. me 5 €/1000m³. Grafikisht te KRU PZ nga pikë e kaltër me vlerë 42.82 €/1000m³ ne e kemi sfiduar dhe aprovuar 37.82 €/1000m³.

Për KRU të cilat kanë performuar më mirë se mesatarja nuk ka nevojë të sfidohen dhe në tabelë kemi paraqitur vlerat negative por të cilat nuk luajnë funksion dhe nuk i ndryshon të dhënat e realizuara pasi janë me performancë të mirë.

I njëjtë parim vlen edhe tek të gjitha tabelat dhe grafikonet për të gjitha kosto qendrat e shpenzimeve

4.2 Shpenzimet operative në distribuim të ujit

Përveç shpenzimeve për prodhimin e ujit një analizë analoge do të bëhet edhe lidhur me kosto qendrën e shpenzimeve për distribuimin e ujit të pjesës. Derisa te prodhimi i ujit krahasimi është bërë mes kostove dhe sasisë së ujit të përpunuar, te distribuimi do të analizohet kosto në lidhje me gjatësinë e rrjetit të ujësjellësit, edhe pse sa i përket të dhënavë të raportuara lidhur me gjatësinë e rrjetit ARRU ka rezerva në saktësinë e raportimit.


Tabela Nr. 2. Shpenzimet operative të realizuara në distribuim të ujit të pjesës përvitin 2018 duke përjashtuar shpenzimet e energjisë

KRU	Shpenzimet në Distribuim €	Rrjeti i ujit në km	Shpenzimet €/km	Krahasimi me mesataren e sektorit	Shpenzimet e sfiduara
PR	1,118,887	1,892	591	-474.11	591
PZ	788,008	509	1,547	481.44	1,386
PE	1,426,122	997	1,430	364.92	1,309
MI	607,360	857	709	-356.62	709
GJA	888,082	772	1,150	84.87	1,122
FE	461,722	380	1,215	149.57	1,165
GJI	331,874	407	815	-250.08	815
SEKTORI	5,622,054	5,814	1065.49		

Sikurse te tabela nr. 1 edhe te tabela Nr. 2 edhe pse kemi mënjanuar shpenzimet operative për shpenzimet e energjisë elektrike për të gjitha KRU-të lidhur me distribuimin e ujit vërehen dallime të dukshme sa i përket kostos për një kilometër të gjatësisë së rrjetit të ujësjellësit (€/km).

Mesatarja e kostove për distribuim në nivel të sektorit është 1,065.49 €/km, por kosto variron nga një KRU te tjetra. Tri nga KRU-të (Prishtina, Mitrovica dhe Hidromorava), kanë kosto më të ulët se mesatarja e sektorit kurse katër KRU-të tjera (Hidroregjioni jugor, Hidrodrini, Gjakova dhe Bifurkacioni), kostot e distribuimit për një kilometër të rrjetit i kanë mbi mesataren respektivisht mbi 1000.00 €/km. Si edhe është cekur më lartë raporti mbi gjatësinë rrjetit na bënë të dyshojmë në saktësinë e vlerave sidomos te rasti i KRU Hidroregjioni-Jugor, ngase mendojmë se rrjeti i kësaj KRU-je duhet të jetë më i gjatë. Nëse nga analiza abstragohet KRU Hidroregjioni Jugor prapë kemi tri KRU të cilat në bazë të të dhënavë shpenzimet

i kanë dukshëm më të larta se kompanitë tjera, ARRU duhet të gjejë një metodë për të standardizuar shpenzimet për të gjitha KRU për nënkatgorinë e shpenzimeve në distribuim.



Sipas parimit të përshkruar nën tabelën e parë te distribuimi janë katër KRU të cilat janë sfiduar për shkak të kostove mbi mesataren e sektorit (PZ,PE,GJA DHE FE).

4.1 Shpenzimet operative në aktivitetet biznesore të ujit


Kosto qendra e fundit për analizë të shpenzimeve përfurnizim me ujë është kosto qendra e aktiviteteve biznesore ose qendra e kostove të përbashkëta. Duke pas parasysh se këtu paraqiten shpenzimet që lidhen me shërbimet e ujit dhe të ujërave të ndotura KRU-të ndarjen e këtyre shpenzimeve e bëjnë duke u bazuar në pjesëmarrjen e shpenzimeve direkte përfujë dhe ujëra të ndotura në totalin e shpenzimeve direkte. Pasi këtu është fjala përfshpenzimet kryesisht administrative mund të ndodhë lehtë që KRU kanë qasje të ndryshme përfundarë shpenzimet e aktiviteteve biznesore në kosto qendrën përfujë dhe ujëra të ndotura. Tabela në vijim paraqet kostot operative përshtatë KRU-të bazuar në shpenzimet operative të cilat vihen në raport me numrin e konsumatorëve

Tabela Nr. 3. Shpenzimet operative të realizuara në aktivitete biznesore të shërbimeve të ujit të pjesës përvitit 2018 duke përashtuar shpenzimet e energjisë

KRU	Shpenzimet ne Euro	Numri i Konsumatoreve	Shpenzimet €/konsumator	Krahasimi me mesataren e sektorit	Shpenzimet e sfiduara €/konsumator
PR	4,322,082	131,576	32.85	13.31	28.41
PZ	684,302	48,591	14.08	-5.46	14.08
PE	279,145	47,516	5.87	-13.66	5.87
MI	602,566	31,797	18.95	-0.59	18.95
GJA	1,018,416	37,406	27.23	7.69	24.66
FE	470,574	27,983	16.82	-2.72	16.82
GJI	632,377	30,161	20.97	1.43	20.49
SEKTORI	8,009,462	355,030	19.54		

Në nivel sektori kosto mesatare përfshpenzimet e aktiviteteve biznesore përfshërbimet e ujit përfundarë konsumatorë 19.54 €/konsumator. Krahasuar me mesataren e sektorit janë katër KRU të cilat kanë arritur të operojnë me më pak se 20.00 €/konsumator (PZ, PE, MI dhe FE). Përkrahasim nga KRU-të e lartë përmendura tri KRU-të tjera shpenzimet i kanë mbi mesataren e sektorit edhe atë KRU Prishtina 32.80 €/konsumator, KRU Gjakova 27.23 €/konsumator dhe KRU Hidromorava 20.97 €/konsumator.

Sfidimi i shpenzimeve në aktivitete biznesore për ujë



Sipas parimit të përshkruar nën tabelën e parë te aktivitetet biznesore janë tri KRU të cilat janë sfiduar për shkak të kostove mbi mesataren e sektorit (PR,GJA dhe GJI).

5 SHPENZIMET OPERATIVE PËR UJËRA TË NDOTURA

Për dallim nga tri kosto qendrat e shpenzimeve për shërbime të ujit tek shërbimet për ujëra të ndotura bazuar në UKRR dhe BPRR kemi katër kosto qendra:

- shpenzimet operative në grumbullimin e ujërave të ndotura
- shpenzimet operative në trajtimin e ujërave të ndotura
- shpenzimet operative në trajtimin e llumit
- shpenzimet operative në aktivitetet biznesore

edhe pse janë katër kosto qendra duke pas parasysh se në nivel të regjioneve ende nuk kemi trajtim të ujërave të ndotura (përjashtuar disa ITUN me kapacitete minimale), në vazhdim do të analizojmë kostot për grumbullimin e ujërave të ndotura dhe kostot për aktivitetet biznesore.

5. 1 Shpenzimet operative për grumbullimin e ujërave të ndotura


Përveç shpenzimeve për kosto qendra për shërbimet e ujit një analizë analoge do të bëhet edhe lidhur me kosto qendrën e shpenzimeve për ujëra të ndotura. Për të krahasuar efikasitetin e shpenzimeve kosto qendrën e grumbullimit të ujërave të ndotura krahasimi është bërë mes kostove operative duke përashtuar shpenzimet e energjisë, me gjatësinë e rrjetit të ujërave të ndotura, edhe pse sa i përket të dhënavë të raportuara lidhur me gjatësinë e rrjetit ARRU ka rezerva në saktësinë e reportimit.

Tabela Nr. 4 Shpenzimet operative për grumbullimin e ujëra të ndotura në raport me gjatësinë e rrjetit duke përashtuar shpenzimet e energjisë

KRU	Shpenzimet në Euro	Rrjeti i kanalizimit në km	Shpenzimet €/km	Krahasimi me mesataren e sektorit	Shpenzimet e sfiduara per gjatsi të rrjetit
PR	16,185	1,093	15	-754	15
PZ	449,531	270	1,665	896	1,366
PE	101,602	135	753	-16	753
MI	116,126	240	484	-285	484
GJA	101,541	81	1,254	485	1,092
FE	172,983	238	727	-42	727
GJI	101,975	210	486	-283	486
SEKTORI			768.89		

Mesatarja e kostove për grumbullim të ujërave të ndotura në nivel të sektorit është 768.89 €/km, por kosto variron nga një KRU te tjetra. Pesë nga KRU-të (Prishtina, Hidrodrini, Mitrovica, Bifurkacioni dhe Hidromorava), kanë kosto më të ulët se mesatarja e sektorit kurse dy KRU-të tjera (Hidroregjioni jugor dhe Gjakova), kostot e grumbullimit për një kilometër të rrjetit i kanë mbi mesatare respektivisht mbi 768.89 €/km. Si edhe është cekur më lartë rapporti mbi gjatësinë rrjetit na bënë të dyshojmë në saktësinë e vlerave të raportuara nga KRU-të.

Sfidimi i shpenzimeve për grumbullimin e ujërave të ndotura



Sipas parimit të përshkruar nën tabelat paraprake te grumbullimi i ujërave të ndotura janë dy KRU të cilat janë sfiduar për shkak të kostove mbi mesataren e sektorit (PZ dhe GJA).

5. 2 Shpenzimet operative për aktivitetet biznesore të ujërave të ndotura


Kosto qendra tjetër për analizë të shpenzimeve për shërbimet e ujërave të ndotura është kosto qendra e aktiviteteve biznesore ose qendra e kostove të përbashkëta. Duke pas parasysh se këtu paraqiten shpenzimet që lidhen me shërbimet e ujit dhe të ujërave të ndotura KRU-të ndarjen e këtyre shpenzimeve e bëjnë duke u bazuar në pjesëmarrjen e shpenzimeve direkte për ujë dhe ujëra të ndotura në totalin e shpenzimeve direkte. Pasi këtu është fjala për shpenzimet kryesisht administrative mund të ndodhë lehtë që KRU kanë qasje të ndryshme për të ndarë shpenzimet e aktiviteteve biznesore në kosto qendrën për ujë dhe ujëra të ndotura. Tabela në vijim paraqet kostot operative për shtatë KRU-të bazuar në shpenzimet operative të cilat vihen në raport me numrin e konsumatorëve

Tabela Nr. 5 Shpenzimet operative në aktivitete biznesore për ujëra të ndotura në raport me numrin e konsumatorëve duke përashtuar shpenzimet e energjisë.

KRU	Shpenzimet ne Euro	Konsumatoret	Shpenzimet për numrin e konsumatorve	Krahasimi me mesataren e sektorit	Shpenzimet e sfiduara €/km
PR	122,413	115,806	1.06	-1.00	1.06
PZ	76,517	44,647	1.71	-0.35	1.71
PE	10,118	24,007	0.42	-1.64	0.42
MI	67,546	25,274	2.67	0.61	2.47
GJA	95,707	27,974	3.42	1.36	2.97
FE	85,664	25,426	3.37	1.31	2.93
GJI	46,536	26,439	1.76	-0.30	1.76
SEKTORI			2.06		

Në nivel sektori kosto mesatare për shpenzimet e aktiviteteve biznesore për shërbimet e ujit për një konsumatorë 2.06 €/konsumator. Krahasuar me mesataren e sektorit janë katër KRU të cilat kanë arritur të operojnë me më pak se 2.06 €/konsumator (PR,PZ,PE, dhe GJI). Për krahasim nga KRU-të e lartë

përmendura tri KRU-të tjera shpenzimet i kanë mbi mesataren e sektorit edhe atë KRU Mitrovica 2.67 €/konsumator, KRU Gjakova 3.42 €/konsumator dhe KRU Bifurkacioni 3.37 €/konsumator.



Sipas parimit të përshkruar nën tabelat paraprake te kosto qendra e aktiviteve biznesore për shërbimet e ujërave të ndotura janë tri KRU të cilat janë sfiduar për shkak të kostove mbi mesataren e sektorit (MIT GJA dhe FE).

6 KONKLUZIONET

Të dhënat për shpenzimet operative janë paraqitur në formë tabelore, për krahasim më të lehtë të rezultateve të arritura nga secila kompani në veçanti dhe sektorit në përgjithësi.

Përveç paraqitjes tabelore për të pas një pamje më të qartë rreth dallimeve në mes të KRU-ve lidhur me shpenzimet për njësi sipas kosto qendrave kemi paraqitur edhe grafikonet për secilën kosto qendër si përfurnizim me ujë po ashtu edhe për shërbimet e grumbullimit të ujërave të ndotura.

Për të vënë në një rrafsh të barabartë për krahasim analiza ka eliminuar shpenzimet e aktiviteteve biznesore te trajtimi i ujit pasi vetëm dy KRU kanë kosto që lidhen me pagesat e ujit me shumicë të pa përpunuar. Gjithashtu te të gjitha kosto qendrat nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e energjisë pasi kosto për Kilovat energji janë të njëjta por disa KRU kanë nevojë për energji më të madhe varësish nga kushtet dhe tereni në zonën e shërbimit.

Edhe përkundër hapave të paraqitur më lartë është evidente dallimi i madh në mes kompanive sa i përket kostove për njësi nëpër kosto qendrat e paraqitura në analizë. Konsiderojmë se një prej arsyeve për dallime të theksuara është edhe ndarja e shpenzimeve sipas kosto qendrave. Si pasoj e kësaj ndarje subjektive ndodh që një KRU ka kosto më të lartë se mesatarja në një kosto qendër dhe në kosto qendrën tjetër ka kosto më të ultë se mesatarja e sektorit.

Analiza do të na shërbej për të qenë më të kujdeshëm gjatë sfidimit dhe aprovimit të shpenzimeve operative për KRU gjatë procesit të ardhshëm tarifor 2021-2023.

Një fakt pozitiv për procesin e ardhshëm është edhe aktiviteti i ARRU dhe angazhimi i projektit mbështetës me të cilin do të unifikohen llogarit kontabël respektivisht plani kontabël unik për të gjitha KRU-të në Kosovë. Me një plan unik kontabël, ARRU do të ketë më të lehtë të sfidoj KRU me rastin e aprovimit të shpenzimeve operative, respektivisht aprovimin e BPRR të KRU-ve.